

Griffbereit

Familien entdecken gemeinsam
Spiel und Sprache



Material drejtuar prindit¹

Ky rishikim nga Marsi i vitit 2020 është financuar nga Ministria e Fëmijëve, Familjes, Refugjatëve dhe Integritit në Nordrhein-Westfalen (MKFFI), dhe nga Auridis Stiftung GmbH.

Baza materiale është përpunuar nga RAA² (tani: Qendra Komunale e Integritit)

- Rrethi RAA Düren
- Rrethi RAA Aachen
- RAA Aachen
- RAA Gelsenkirchen

dhe në bashkëpunim me mbështetësit e prindërve Gülten Dočan, Sabine Engelmann dhe Nadja Pazzini si dhe me mbështetjen nga Freudenberg Stiftung GmbH.

Bazuar në programin "Bii de Hand" nga Stichting Samenspel Rotterdam.

¹ Ne nuk duam të riprodhojmë ose solidarizojmë stereotipet me ilustrime. Qëllimi është të përshkruajmë shoqërinë tonë të larmishme – sa më shumë që të jetë e mundur.

² Me ligjin për promovimin e pjesëmarrjes sociale dhe integritin në Nordrhein-Westfalen të shkurtit 2012, shteti ka theksime të reja në politikën e integritit dhe arsimit. Me nenin 7, ligji rregullon promovimin e qendrave komunale të integritit nga zyra e mbikëqyrjes në mbarë shtetin (LaKI), e cila përbëhet nga ish zyra kryesore e RAA-s në Nordrhein-Westfalen dhe pjesë e qendrës së kompetencave për integritim në qeverinë e rrethit Arnsberg.

Tabela e përmbajtjes

Material drejtuar prindit	2
Parathënia për prindërit	6
Parathënia për Griffbereit-shoqëruesit dhe Griffbereit-shoqërueset e prindërve	7
1 Të Tregosh	9
2 Trokit duart	10
3 Të Lenkundesh	11
4 Të fshehësh gjëra	12
5 Të shohësh libra	13
6 Hoppla Hopp	14
7 Të vizatosh	15
8 Të shikosh kafshë	16
9 Ti biesh daulles	17
10 Të hapësh dhe të mbyllësh	18
11 Të kërzhesh	19
12 Në shkallë po vjen lart një burrë	20
13 Nopper	21
14 Të pish çaj	22
15 Brënda dhe jashtë	23
16 Të imitosh njëri tjetrin	24
17 Librat	25
18 Lodra duke prekur	26
19 Të pikturosh	27
20 Të hecësh me varkë	28
21 Të lozësh me ballona	29
22 Piramidë me rathë	30
23 Kënga për trupin	31

24	Të lozësh me kuklla dhe arusha lodre	32
25	Një shëtitje	33
26	Sytë, veshët, hunda dhe goja.....	34
27	Të lozësh me letër	35
28	Tavolinë pune.....	36
29	Të bësh zhurma.....	37
30	Të lozësh me copa druri	38
31	Të tregosh diçka për kafshët	39
32	Vrapo, Can – vrapo, Gül	40
33a	Të zbërthesh një puzzle	41
33b	Të formosh një puzzle	42
34	Të hecësh mbi këmbët e tjetrit.....	43
35	Të ngjisësh	44
36	Të frysh topat	45
37	Të lozësh si blihet në dyqan	46
38	Të sistemojmë lodrat së bashku	47
39	Hop, hop, hop – Hec kali me galop	48
40	Të lozësh me plastelinë	49
41	Të bësh si tren	50
42	Ti shkosh ruazat në pe.....	51
43	Të bësh një kollotumba.....	52
44	Një lojë me gishta	53
45	Libra me figura	54
46	Të pikturosh me Bojra uji	55
47	Lloto me figura	56
48	Të Ndjeje	57
49	Lojë me të veshura.....	58
50	Kala me gota	59

51	Të ndihmosh në shtëpi.....	60
52	Unë shoh çfarë ti nuk shikon	61
53	Memory (Kujtesa)	62
54	Të lozësh përjashta me rërë.....	63
55	Ta rotullosh topin dhe të marësh shënjë	64
56	Dëgjo tamam edhe kërkohet.....	65
57	Të mësosh të vishesh	66
58	Të bësh vetë një puzzle	67
59	Të tregosh me një libër	68
60	Të tregosh me një çorape	69
61	Çfarë shkon me njëra-tjetrën?.....	70
62	Të lozësh me lego dhe duplo	71
63	Pjesët e trupit	72
64	Familja ime	73

Parathënia për prindërit

Të dashur Prindër,

Në këtë dosje të grup lojrave “Griffbereit” mundeni të mblidhni fletë me propozimet për lojra. Në këto faqe shpjegohet si lojrat dhe aktivitetet (veprimet) mund ta kënaqin fëmijën tuaj njëkohësisht duke pasur dhe një efekt mësimor.

Faqet me lojra kanë për qellim të shikohen dhe një herë në shtëpi. Ato mundet të jenë një ndihmë për të luajtur edhe njëherë me fëmijën tuaj këto aktivitete në shtëpi.

Tregojini idetë dhe regullat e lojrave edhe pjestarëve të tjerë të families tuaj, për ti motivuar edhe ata që të lozin këto lojra me fëmijën.

Në qoftëse keni pyetje ose komente për sqarimet e lojrave, mundeni në çdo kohë të flisni me dretuesin ose dretuesen e grupit të lojrave.

Ne ju urojmë ju dhe fëmijës tuaj shumë kënaqsi duke luajtur!

Parathënia per Griffbereit-shoqëruesit dhe Griffbereit-shoqërueset e prindërve

Të dashur shoqërues dhe shoqëruese të prindërve,

ne kemi mbledhur për ju dhe prindërit tuaj të grup lodrave “Griffbereit” një koleksion prej 64 idesh për lodra. Këto lodra mundet ti lozi mamaja ose babai bashkë me fëmijën. Neve ju rekomandojmë të ushtroheni ti luani veprimet e ndryshme të lojrave njëherë bashkë me prindërit në mbledhjet javore. Lojrat janë konceptuar në mënyrë që fëmijët të motivohen të lozin dhe mësojnë njëkohësisht.

Disa lodra janë bërë për fëmijë më të vegjël, e disa janë përshtatur për fëmijë më të ritur. Ju duhet të shikoni bashkë me prindërit cilat pjese janë më të përshtatëshme për fëmijët e tyre. Lodrat janë renditur simbas moshës dhe shkallës së interesimit të fëmijës. Të gjitha lodrat luhen njëloj nga djemtë dhe vajzat.

Duhet të kihen parasysh paranjojat dhe experiencat e ndryshme të prindërve me lojrat. Sqarojini prindët në fillim çfarë stimulon në shvillimin e fëmijes dhe çfarë është objektivi i lojës për një lojë të caktuar (për shëmbull Nr. 4: “Të fshehësh gjera” = femija shvillon kujtesën dhe mëson fjalë të reja.)

Kryesorja është në radhë të parë loja e përbashkët me fëmijën, dhe pastaj ushtrimi i programit. Prindërit mund të sjellin dhe idetë e tyre për lojra të ndryshme. është e rëndësishme gjithashtu që prindërit bashkë me fëmijën të flasin me fëmijet për veprimin që kryejnë. Për fëmijët është më e thjeshtë që të mësojnë një gjuhë, nëqoftëse mundet të flasin për gjithçka që janë duke bërë. Sa më mirë që të fëmijët flasin, aq më e lehtë është për ata që të komunikojnë (bashkohen) me fëmijët e tjerë.

Mundsisht sqarohini prindërve këto pika saktë:

- Gjatë lojës prindërit duhet tu sugjerojnë veprimet fëmijëve dhe njëkohësisht ti lënë që ta ndajnë vetë çfarë dëshirojnë që të bëjnë. Për shëmbull në Nr. 4: “Të fshehësh gjëra” = “Të fus disa gjëra poshtë picetës apo vetëm një?”. Për një fëmijë është e rëndësishme që ti shprehë dëshirat dhe ndjenjat.
- Prindët duhet të kuptojnë pse dhe çfarë veprimesh duhet të kryejnë gjatë lojës me fëmijën.
- Prindët duhet ta lavdërojnë fëmijën nëqoftëse e bën një gjë në rregull. Në fund të fletëve për prindët ka gjithmonë shëmbuj “lavdërimesh”. Këto shëmbuj janë konceptuar si propozime të ndryshme.
- Prindët duhet ti japin kurajo fëmijës nëqoftëse nuk e arin objektivin e lodrës që me herën e parë.

Kur të takoheni me prindët të nesërmen, bisedoni me ata për experiencën që mbledhën duke luajtur me fëmijën në shtëpi lodrat e propozuara. Lavdëroni dhe inkurajohini që të vazhdojnë lodrat me fëmijën.

Udhëzuesin e plotë për realizimin e grup lodrave simbas konceptit Griffbereit e gjeni në “Udhëzuesi për Griffbereit-shoqëruesit dhe Griffbereit-shoqërueset e prindërve”. Ky udhëzues përmban në mënyrë të detajuar gjithë informationet e rëndësishme të konceptit. Në internet keni mundësin të shkarkoni (Herunterladen) këto të dhëna:

- Udhëzuesi për Griffbereit-shoqëruesit dhe Griffbereit-shoqërueset e prindërve
- 64 pjesë të programit në gjuhën gjermane
- 64 pjesë të programit në gjuhën turke
- 64 pjesë të programit në gjuhën ruse
- 64 plane shtesë për zgjerimin e programit origjinal

Suksese me realizim e grupeve prindërve-fëmijë simbas konceptit Griffbereit!

1 Të Tregosh



Çfarë mëson fëmija juaj?

- Të shikojë me vëmendje
- Të kuptojë fjalë
- Të përsërisi fjalët që dëgjon

Çfarë ju duhet?

- Nji vënd i caktuar (për shëmbull shtëpia tuaj, shtëpia e komshiut)

ÇFARË MUND TË BËNI?

- Mereni fëmijn në krahë ose në prehr.
- Shikoni atje ku po shikon dhe fëmija tuaj.
- Tregoni atje dhe thoni emrin e objektit ku femija po shikon.
- Tregoni kolltukun, llambën, karigen dhe thoni emrat e këtyre objekteve.
- Pyeteni fëmijën: “Ku është llamba? Ku është karigja?”

Lavdëroni fëmijën për çfarë ka bërë në regull:

- Ti e kuptove shumë bukur se ku unë tregova.

2 Trokit duart



Çfarë mëson fëmija juaj?

- Fjalë
- Të imitojë lëvizje
- Ritëm

Çfarë ju duhet?

- Nuk ka nevojë për materiale

ÇFARË MUND TË BËNI?

- Uluni përballë dhe këndoni bashkë njëkohësisht duke bërë lëvizje që i përshtaten këngës:

Duartrokit,
i kënaqur, i kënaqur, i kënaqur
dhe tashti ne kok,
kështu, kështu, kështu.
duart lart,
pastai uli duart anash,
kështu notojnë varkat në liqen,
djathtas
kështu notojnë varkat në liqen,

Duartrokit
trokiti duart në kokë
zgjati duart lart
duart anash drejtoji
lëviz me trupin majtas-

Lavdëroni fëmijën për çfarë ka bërë në regull:

- Ti i ngre duart shumë lart.
- Ti po këndon bashkë me mua (nëqoftëse fëmija belbëzon).

3 Të Lëkundesh



Çfarë mëson fëmija juaj?

- Të bëjë gjëra bashkarisht

Çfarë ju duhet?

- Nuk ka nevojë për materiale

ÇFARË MUND TË BËNI?

- Uleni fëmijën përpara jush në tokë.
- Shkoni mbrapa fëmijës dhe uluni në gjunjë.
- Kalohini duart tuaja poshtë kofshëve të fëmijës.
- Gërshetohini duart fort poshtë fëmijës.
- I thoni fëmijës që do e lëkundni dhe pastai filloni ti lëvizni duart përpara, mbrapa dhe në anët.
- Njëkohesisht mund të këndonit “Të lëkundesh, të lëkundesh, të lëkundesh”.

Lavdëroni fëmijën për çfarë ka bërë në regull:

- Flisni me fëmijën duke e lëkundur dhe lavdëroheni.

4 Të fshehësh gjëra



Çfarë mëson fëmija juaj?

- Të ushtrojë të menduarit
- Fjalë të reja

Çfarë ju duhet?

- Një picetë
- Sende që mund të futen poshtë picetës

ÇFARË MUND TË BËNI?

- Lëreni fëmijën tuaj që ti shohi dhe ti preki sendet dhe picetën, ndoshta fëmija do dojë dhe që ti fusi ato në gojë.
- Fshihni një send poshtë picetës, për shëmbull një filzhan.
- Pyeteni fëmijën: “Ku është filzhani?”.
- Ju ose fëmija juaj do tërhiqni picetën. “Këtu është filzhani!”
- Përseriteni lojën duke fshehur një send tjetër.
- Fshihni njëherë fytyrën tuaj mbrapa picetës dhe pastaj tërhiqeni picetën, duke thënë “Kuku”.

Lavdëroni fëmijën për çfarë ka bërë në regull:

- Flisni më fëmijën duke e tundur dhe lavdëroheni.

5 Të shohësh libra



Çfarë mëson fëmija juaj?

- Të kuptojë fjalë
- Të kuptojë figurat
- Të njohi librat, dhe të kuptojë si përdoren

Çfarë ju duhet?

- Libra me kopertinë kartoni të fortë, plastike ose robe, të cilat kanë një ose dy figura në çdo faqe.

ÇFARË MUND TË BËNI?

- Fëmija mundet ta shohi librin dhe ta hapi.
- Vini gishtin tek figurat dhe tregoni diçka për to.
- Bëni dhe pyetje për figurat, për shëmbul "Ku janë pantallonat? Ke dhe ti pantallona të veshura?"
- Për fëmijë të vegjël shpesh mjafton tju tregosh vetëm një figurë.

Lavdëroni fëmijën për çfarë ka bërë në regull:

- Kur shikojm libra bashkë bëjmë shumë qef!

6 Hoppla Hopp



Çfarë mëson fëmija juaj?

- Të bëjë gjëra bashkarisht
- Të mbajë ekuilibrin

Çfarë ju duhet?

- Nuk ka nevojë për materiale

ÇFARË MUND TË BËNI?

- Uleni fëmijën në prehërin tuaj, në mënyrë që ta shikoni njeri tjetrin.
- Mbaheni trupin e fëmijës me duart tuaja.
- Lëkundeni fëmijën duke ngritur njëher njërin gju, dhe pastai tjetrin duke thënë:

Hop, hop Kalorës,
Kur rëzohet, ai bërtet.
Kur ai rëzohet në kanal,
Atë e hanë korbata.
Kur ai rëzohet në lluc,
Ai bën plluc!

- Tek “plluc” hapini gjunjët pak sa fëmija të shkasi pak brënda
- Tek “Hop, hop” hidheni fëmijen më lartë se normalisht

Lavdëroni fëmijën për çfarë ka bërë në regull:

- Ti e luan shumë mirë kalorësin.

7 Të vizatosh



Çfarë mëson fëmija juaj?

- Të mbajë lapsa të ndryshëm
- Të vizatojë viza, linja dhe më pas rathë
- Të aktivisohet kreativisht

Çfarë ju duhet?

- Lapsa me ngjyrë të shkurtër dhe të trashë njëkohësisht ose shkumësa
- Një copë e madhe letër ose karton (mund të jetë dhe e përdorur) ose mund të shkruani në trotuar

ÇFARË MUND TË BËNI?

- Uluni me materialin e vizatimit në tavolinë.
- Jepini fëmijës lapsin dhe letrën
- shikoni çfar bën ai me ato.
- I tregoni fëmijës si vizatohet: vizatoni disa viza dhe pika.
- Vizatoni për aq kohë sa i bën qef fëmijës (normalisht disa minuta).
- Në fund shikoni bashkë vizatimet; thoni çfarë shikoni
- Vareni vizatimin diku ose vereni në një vënd ku ai dallohet mirë.

Lavdëroni fëmijën për çfarë ka bërë në regull:

- Kjo viza blu është e bukur.
- Ti i bën pikat shumë bukur!

8 Të shikosh kafshë



Çfarë mëson fëmija juaj?

- Të njohi kafshët në ambiente të ndryshme; Si duken ato? Çfarë bëjnë ato? Çfarë zhurma bëjnë ato? Si janë ato po ti prekësh?
- Emrin e kafshëve dhe të pjesëve të trupit të tyre

Çfarë ju duhet?

- Një ose më shumë kafshë tek të cilat mundeni të shkoni (për shëmbul mundeni të vizitoni një kopsht zologjik).

ÇFARË MUND TË BËNI?

- Mundeni të kërkon bashkë një ose më shumë kafshë, dhe nëqoftëse ato janë të zbutura atëherë dhe ti fërkoni.
- Thuajini fëmijës emrin e kafshës.
- Bëni zhurmat që bëjnë kafshët dhe i thoni fëmijës që dhe ai të provojë që ti imitojë ato.
- Ju mundeni të këndoni bashkë me fëmijën këngen "Old Mac Donald".
- Tregoni kokën, putrat, bishtin dhe trupin e kafshëve dhe shpjegoni çfarë i ndimojnë të bëjnë me to. (të hajë, të rijë në këmbë, ta tundë, të zbojë mizat)
- Vini re çfarë i pëlqen fëmijës dhe tregojini më shumë për atë gjë.

Lavdëroni fëmijën për çfarë ka bërë në regull:

- Shumë bukur, kështu e fërkon butë, kjo i pëlqen qenit.
- Ti e imiton shumë mirë dhinë: meeeh, meeeh.

9 Ti biesh daulles



Çfarë mëson fëmija juaj?

- Të bëjë zhurma të ndryshme me një shkop ose me një garuzhde.
- Të dallojë ndyrshimet e zhurmave, kjo është e rëndësishme për të mësuar gjuhën.

Çfarë ju duhet?

- Një kanaçe më kapak, bosh ose e mbushur me bizele apo oris, ose një daulle.
- Një shkop ose një garuzhde

ÇFARË MUND TË BËNI?

- Mbusheni kanaçen me bizele ose oris dhe mbylleni kapakun fort.
- Fëmija juaj mundet të lozi me të: ta godasi kanaçen me shkop, ta tundi ose ta rokullisi atë.
- Ju mund ti tregoni si ta godasi kanaçen ose daullen fort ose butë.
- Njëkohësisht i thoni fëmijës fjalët “fort” dhe “butë”.
- Ju mund ti tregoni fëmijës si të godasi gjëra të tjera si dyshemenë ose tavolinën.
- Fëmija mund ti përsërisi zhurmat që dëgjon.
- Ju dhe fëmija mund të godisni me këmbë dyshemenë (kini kujdes nëqoftëse banoni në hyrje me qira)

Lavdëroni fëmijën për çfarë ka bërë në regull:

- Shumë mirë, ti e bën këtë shumë bukur.
- Ti tashti je në gjendje ta godasësh dyshemenë fort dhe butë.

10 Të hapësh dhe të mbyllësh



Çfarë mëson fëmija juaj?

- Të lëvizi gishtat dhe duart qëllimisht
- Mënyra të ndryshme për të hapur dhe për të mbyllur gjera
- Të ushtrohet të mendohet
- Fjalet e “hapur” dhe e “mbyllur”

Çfarë ju duhet?

- Gjëra që hapen dhe mbyllen në mënyra të ndryshme, si për shëmbul kuti shkrepseje, një kuti me kapak, një kanoçe me biskota, një kanoçe me kapak në trup.

ÇFARË MUND TË BËNI?

- Jepini fëmijës kutinë ose kanoçen dhe lëni atë që ti shikojë ato tamam.
- Tregojini fëmijës si hapet dhe mbyllet për çdo njërin.
- Thoni gjatë kësaj gjithmonë fjalet e “hapur” dhe e “mbyllur”.
- Mëni duart e fëmijës me duart tuaja dhe hapini e mbyllini gjërat bashkë.
- Kur fëmija ti ketë mësuar këto gjëra do dojë që ti përsërisi shpesh

Lavdëroni fëmijën për çfarë ka bërë në regull:

- Shumë mirë e hape ti kanoçen.
- Ti e mbyllën dot derën tani.

11 Të kërzesht



Çfarë mëson fëmija juaj?

- Të ju digjojë
- Ritmus
- Të lëvizë bashkë me ju

Çfarë ju duhet?

- Muzik


ÇFARË MUND TË BËNI?

- Hapni muzikën ose këndoni vet.
- Mereni fëmijën në krahë ose mbajeni prej duarsh.
- Kërzeni bashkë me fëmijën tuaj.

Lavdëroni fëmijën për çfarë ka bërë në regull:

- Sa bukur që kërcejmë ne së bashku!

12 Në shkallë po vjen lart një burrë



Çfarë mëson fëmija juaj?

- Të bëjë gjëra bashkarisht

Çfarë ju duhet?

- Nuk ka nevojë për materiale

ÇFARË MUND TË BËNI?

- Mereni fëmijën tuaj në prehr, në mënyrë që ta shikoni njeri tjetrin.
- Me dy gishta hecni nga dora e fëmijes deri tek qafa duke thënë:

Në shkallë po vjen lart një burrë

- Kapeni veshin e fëmijes dhe tundeni let ...

klinglelingeling

- Trokisni let në ballin e fëmijës ...

në der troket

- Kapeni hundën e fëmijes dhe tundeni let ...

Mirë dita, zoti Nusret

Lavdëroni fëmijën për çfarë ka bërë në regull:

- Ti e tregon shumë bukur përallën!
- Ti e luan shumë bukur lojën me gishta e tua!

13 Nopper



Çfarë mëson fëmija juaj?

- Të ushtrojë lëvizjet e krahëve dhe duarve
- Të kuptojë si kombinohen pjesët e ndërtimit
- Të koordinojë sytë me duart

Çfarë ju duhet?

- Nopper

ÇFARË MUND TË BËNI?

- Lereni fëmijen në fillim ti preki pjesët e ndërtimit dhe të lozi i lirë. Shikoni me vëmendje çfarë bën fëmija
- Tregojini fëmijës si mund ti bashkojë pjesët me njëra tjetrën.
- Pjesët e bashkuara i vini mbi njëra tjetrën për ti treguar fëmijës që ato qëndrjnë bashkarisht.
- Përsëriteni këtë, mbasi ndoshta fëmija ju imiton.
- Zbërthejini pjesët prapë,
- Në atë farë mënyre që fëmija t'ju ndjek.
- Bëni kujdes të ndihmoni fëmijën tuaj kur pjesët e lidhura fort me njëra tjetrën do
- që ti zbërthejë

Lavdëroni fëmijën për çfarë ka bërë në regull:

- Po, tërhiqi pjesët me shumë fuqi për ti ndarë ato!
- Sa bukur i ndërton ti!

14 Të pish çaj



Çfarë mëson fëmija juaj?

- Të bëjë sikur edhe të krijojë gjëra
- Të lozi dhe të flasi bashkë me ju
- Të koordinojë sytë me duart

Çfarë ju duhet?

- Filxhane ose gota
- Lugë të vogla
- Një ibrik të vogël

ÇFARË MUND TË BËNI?

- Shikoni bashkë me fëmijën tuaj filxhanët, lugët dhe ibrikun edhe flisni me fëmijën tuaj për këto gjera
- Bëni sikur po mbushni një filxhan me çaj dhe po e pini.
- Beni sikur po mbushni një filëhan tjetër me çaj dhe jepjani këtë fëmijës tuaj: “Shiko, një filxhan me çaj. Do pish dhe ti një filxhan çaj?”.
- Lutjuni fëmijës tuaj t’ju mbushi ai një filxhan me çaj dhe bëni sikur po e pini

Lavdëroni fëmijën për çfarë ka bërë në regull:

- Çaj që më dhe ti më shijovi shumë mire! Unë do pija me kënaqësi dhe një filxhan tjetër.
- Ti e mbush shumë mirë filxhanin me çaj. Cilit do ja japësh filxhanin tashti?

15 Brënda dhe jashtë



Çfarë mëson fëmija juaj?

- Të zhvillojë mëndjen e tij
- Të përdori fjalët brënda dhe jashtë

Çfarë ju duhet?

- Një kuti me gota, lugë, kuti të vogla dhe kanoçe (kuti kartoni bosh)

ÇFARË MUND TË BËNI?

- Shikoni bashkë me fëmijën tuaj të gjitha gjërat dhe lëreni të lozi me to për aq kohë sa do.
- Tani futni lugën në gotë dhe gotën në një kanoçe.
- I thoni fëmijës tuaj qartë: “Shiko, unë po fus lugën BRËNDA në gotë dhe gotën BRËNDA në kanoçel!”.
- Lutjuni fëmijës tuaj të fusi një kuti të vogël BRËNDA në kutinë e madhe. Në qoftëse ka nevojë, atëherë ndihmojeni atë.
- Më pas nxirini gjërat jashtë kutisë dhe njëkohësisht thoni qartë: “Unë po i nxjer gjërat prapë JASHTË kutisë.”
- Futini dhe nxirini gjërat BRËNDA dhe JASHTË nga kutia tashti, bashkë me fëmijën tuaj.

Lavdëroni fëmijën për çfarë ka bërë në regull:

- Shumë mirë kështu, kështu e mban gotën shumë mirë, tashti fute atë BRËNDA në kuti. Mere lugën nga gota. Ti e bën këtë shumë mire!

16 Të imitosh njëri tjetrin



Çfarë mëson fëmija juaj?

- Të shikojë tamam
- Të imitojë një njeri

Çfarë ju duhet?

- Nuk ka nevojë për materiale

ÇFARË MUND TË BËNI?

- Përsëriteni fëmijën tuaj me dorë dhe pyeteni: “Do bësh si unë? Ma bëj dhe ti me dorë.”
- Mbasi ta keni përsëritur me dorë, bëni një lëvizje tjetër dhe lutjuni fëmijës tuaj që dhe ai ta bëjë atë.
- Shikoheni fëmijën tuaj dhe pastaj bëni ju një nga lëvizjet e tij.
- Këndoni një këngë që shkon me këto lëvizje, për shëmbul:

Unë pashë një herë një dyqan kukullash,
 Që kishte shumë kukulla.
 Pronari i dyqanit u nis për të bërë një udhëtim,
 Kukullat filluan të bëjnë të gjitha gjerat në mënyrën e tyre.
 Ato bënin një herë kështu ... (për shëmbul duartrokisni)
 Ato bënin një herë kështu ... (për shëmbul trokisni gishtat)
 Ato bënin një herë kështu ... (për shëmbul ti biesh daulles me duar)
 Ato bënin një herë kështu ... (për shëmbul ti biesh daulles me duar)

Lavdëroni fëmijën për çfarë ka bërë në regull:

- Sa mirë më imiton ti mua!
- Sa bukur që ti di të përsëritësh me dorë/ të duartrokasësh/ të trokasësh gishtat/ ti biesh daulles me duar!

17 Librat



Çfarë mëson fëmija juaj?

- Të shikojë figura dhe libra
- Të digjojë çfarë i tregohet
- Mëson gjuhen

Çfarë ju duhet?

- Një libër që bën fjalë për robat.

ÇFARË MUND TË BËNI?

- Mereni fëmijën tuaj në prehër ose uleni anash jush në një kolltuk.
- Lëreni fëmijën tuaj ti shikojë figurat në libër.
- Tregoni çfarë tregojnë figurat. Krijoni një histori për ato; mos thoni vetëm emrin e copave të ndryshme të veshjes.
- Tregojini fëmijës robat e ndryshme që duken në figura dhe pyeteni fëmijën tuaj: “Ku është këmisha jote?”.
- Lëreni fëmijën tuaj që ta ndrojë ai faqen.
- Nëqoftse fëmija juaj e thotë diçka gabim atëhere përsëriteni fjalën duke thënë të gjithë fjalinë e plotë. Për shëmbul fëmija juaj thotë “padona” (për pandallonat), atëhere i thoni “Po, këto janë një palë pandallona!”

Lavdëroni fëmijën për çfarë ka bërë në regull:

- Sa bukur që ti e shikon librin!
- Ti e ndëron dot faqen vetë.

18 Lodra duke prekur



Çfarë mëson fëmija juaj?

- Të preki me duar

Çfarë ju duhet?

- Gjëra prej materiali të ndryshëm, për shëmbul prej leshi, plastike, druri, xhami, metali

ÇFARË MUND TË BËNI?

- Rjeshtojini gjërat, për shëmbull një shall ose një arush lodre, një kanoçe plastike, një lugë të vogël, një shishe qumështi, një lugë, ...
- Prekini ju dhe fëmija juaj gjërat e ndryshme me duart dhe me faqe.
- Flisni me fëmijën tuaj çfarë janë ato dhe si ndihen ato:
- Të forta ose të buta; të lëmuara ose të ashpra; të ngrohta ose të ftohta; të rehatshme ose të parehatshme.

Lavdëroni fëmijën për çfarë ka bërë në regull:

- Ti i ndjen gjërat me hundën tënde, kjo është një ide e mir!
- Po ke të drejtë, kjo është e ftohtë.

19 Të pikturosh



Çfarë mëson fëmija juaj?

- Të ushtrojë lëvizjen e duarve
- Të përdori sytë dhe duart bashkarisht
- Të aktivizohet në mënyrë kreative, të vëri në përdorim fantazinë

Çfarë ju duhet?

- Një shtresë plastike (për shëmbull një qese plerash)
- Një faqe gazete ose një letër tjetër për ta ngjyrosur.
- Një penel me bisht të trashë dhe të shkurtë
- Ngjyra të tretura në ujë në një gotë të vogël
- Një qese plastike plerash dhe një gërshërë

ÇFARË MUND TË BËNI?

- Vëreni qesen plastike në tavolinë dhe thoni çfarë doni që të bëni tashti.
- Prisni tre vrima tek qesja e plerave (për kokën dhe duart), dhe “vishjani” këtë fëmijës që mos bëhet pisë duke ngjyrosur.
- Pregatitni gazetën, penelin dhe bojën.
- Ngjyeni penelin në bojë dhe vizatoni një pikë të madhe ose një vizë tek fleta.
- Jepjani fëmijës tuaj penelin. Ndhimoeni atë (në qoftse ka nevojë) për ta ngjyer penelin në bojë dhe për të pikturuar. Lëreni edhe që të provojë të pikturojë vetë

Lavdëroni fëmijën për çfarë ka bërë në regull:

- Kjo pika e kuqe është e bukur.

20 Të hecësh me varkë



Çfarë mëson fëmija juaj?

- Fjalë
- Të lozi bashkarisht

Çfarë ju duhet?

- Nuk ka nevojë për materiale

ÇFARË MUND TË BËNI?

- Uluni me fëmijën tuaj në tokë, përballë, ashtu që ta shikoni njëri tjetrin.
- Kapeni njëri tjetrin prej duarve.
- Bëni sikur jeni bashkë në një varkë dhe po i jepni lopatave: Tërhiqini të dyja duart e fëmijës dhe përkuleni kurizin nga mbrapa. Pastaj i shtyini duart e fëmijës dhe përkuluni përpara.
- Ndroni herë pas here shpejtësinë ose jepini lopatës vetëm në një anë.
- Flisni më njëri tjetrin gjat kësaj ose këndoni bashkë.

Lavdëroni fëmijën për çfarë ka bërë në regull:

- Ti i jep lopatave shumë mirë!

21 Të lozësh me ballona



Çfarë mëson fëmija juaj?

- Zbulon
- Mënyra të ndryshme për
- Të lozur me një gjë.
- Të lëvizzi më mirë

Çfarë ju duhet?

- Një ose më shumë ballona
- Një copë spango (pe) e vogël.

ÇFARË MUND TË BËNI?

- Fryeni ballonin dhe pastaj lëni ajrin që të dalë jashtë saj duke fishkëllur.
- Fryeni dhe njëherë ballonin dhe lëshoheni pastaj ashtu që ai të fluturojë.
- Fryeni ballonin (jo shumë, që mos pëllcasi) dhe lidhni grykën.
- Lëni fëmijën ta preki ballonin, ti mari erë, ta godasi, ta pickojë, ta kapi dhe ta fshehi. Thoni gjithmonë çfarë bën fëmija juaj.
- Tashti mundeni të lozni me ballonin sikur ai është top duke e goditur atë.

Lavdëroni fëmijën për çfarë ka bërë në regull:

- Sa lart që ti e hedh ballonin!
- Sa bukur që ti e kap ballonin!

22 Piramidë me rathë



Çfarë mëson fëmija juaj?

- Të kontrolloj duart e veta
- Të dallojë ngjyrat dhe madhësit e ndryshme të rathëve
- Ti përdori sytë dhe duart bashke; Të ushtrojë lëvizjet dhe shikimin

Çfarë ju duhet?

- Një piramidë me rathë

ÇFARË MUND TË BËNI?

- Jepjani piramidën fëmijës tuaj që të lozi me atë aq gjatë sa të dojë.
- Tregojini fëmijës tuaj si ti vëri rathët në shkop (renditja nuk ka rëndësi në fillim).
- Provoni me fëmijën tuaj ti vini rathët njëri mbi tjetrin (pa shkopin) ose lini ato që të rotullohen.
- Tregoni gjithmonë çfarë jeni duke bërë.

Lavdëroni fëmijën për çfarë ka bërë në regull:

- Po, ti mundesh ta vësh rethin dhe në kokën tënde.
- Ti ndërtove një piramidë të bukur.
- Sa bukur që ti i rotullon rathët.

23 Kënga për trupin



Çfarë mëson fëmija juaj?

- Emrat për pjesët e ndryshme të trupit
- Të lëvizi bashkë me musikën

Çfarë ju duhet?

- Një këngë

ÇFARË MUND TË BËNI?

- Uluni përballë njëri-tjetrit.
- Këndoni bashkë një këngë, për Shëmbul “Syt e mia u zhdukën” ose thoni një vjershë dhe shoqëroheni me lëvizje.

Duart në prehër – un jamë shumë i lumtur.
 Duart në kuriz – tashti përkulu
 Duart në gjunjë – tri-li-li
 Duart në bark – këtë e bën dot dhe ti!

Lavdëroni fëmijën për çfarë ka bërë në regull:

- Sa bukur që ti këndon! Sa bukur që ti lëviz!
- Ti i njeh pjesët e trupit tënd shumë mirë.

24 Të lozësh me kuklla dhe arusha lodre



Çfarë mëson fëmija juaj?

- Të kopjojë të lozi një ngjarje
- Ta fusi veten e tij në role të tjera dhe të provojë një sjellje tjetër duke luajtur
- Të mësojë të flasë (të krijojë fjalë dhe fjali)
- E rëndësishme dhe për djemtë, jo vetëm vajzat

Çfarë ju duhet?

- Kuklla të ndyrshme (djem dhe vajza), arusha lodre
- Një pjatë të vogël dhe një lugë të vogël (enët normale të shtëpisë)
- Një picetë, një peshqir dhe një leckë për tu larë

ÇFARË MUND TË BËNI?

- Lëreni fëmijën të lirë në fillim të lozi me kukllën ose arushin.
- Nëqoftse fëmija është duke luajtur me kukllën atëhere mos e shqetësoni. Nëqoftse fëmija nuk di çfarë të bëjë me kukllën, atëhere jepini idera çfarë ai mund të bëjë ato, për shëmbull “Ndoshta mos ka uri kuklla?”. Merreni pjatën dhe lugën dhe bëni sikur po e ushqeni kukllën.
- Trëgojini fëmijës si mund da veshi dhe ta zhveshi kukllen ose ti ndërojë bibilinat asaj.
- Gjatë lojës shoqërojnë veprimet me fjalë.

Lavdëroni fëmijën për çfarë ka bërë në regull:

- Ti po i jep kukllës një gjë të shijshme për të ngrënë?
- Ti e do shumë kukllën.
- I ke dhënë një emër kukllës?
- Ky është një emër i bukur.

25 Një shëtitje



Çfarë mëson fëmija juaj?

- Të mbajë një drejtim kur është duke vrapuar
- Fjalë dhe fjali për gjërat që shikon

Çfarë ju duhet?

- Nuk ka nevojë për materiale

ÇFARË MUND TË BËNI?

- Bëni bashkë jashtë ose brënda në shtëpi një shëtitje.
- Kujdesni ku po shikon fëmija juaj dhe tregojini diçka për atë gjë:

Kjo është përjashta. Do që të shikojmë një herë përjashta? Çfarë shikon ti atje, një pemë dhe një qen? Qeni po vrapon. Qeni ka një bisht, e shikon ti atë? Qeni po e tund bishtin. Çfarë po digjon ti, një makinë? Shiko, sa makinë e madhe.”

- Nëqoftëse i flisni fëmijës shumë, në gjuhën tuaj, atëhere fëmija meson të flasi mirë.

Lavdëroni fëmijën për çfarë ka bërë në regull:

- Sa larg që ti vrapon.
- Ti po flet shumë bukur me mua.

26 Sytë, veshët, hunda dhe goja



Çfarë mëson fëmija juaj?

- Emrat e pjesëve të ndryshme të fytyrës
- Nëqoftse përdorni një libër, fëmija juaj mëson ti njohi librat: Ato çfarë ai shikon në libra ato egzistojnë dhe në realitet.

Çfarë ju duhet?

- Nuk është e domosdoshme por ju mund të përdorni një libër, portrete ose edhe kuklla.

ÇFARË MUND TË BËNI?

- Filloni të tregoni tek pjesët e fytyrës, që fëmija juaj ndoshta i njeh dhe tregoni çfarë mund të bëhet me to: “çfarë mund të bëj unë me gojën? Të flas ose të ha.”
- Tregoni veshin tuaj dhe thoni “Ky është veshi im. Dhe Ti ke një vesh.” Pastaj tregoni veshin e fëmijës tuaj dhe thoni “Ky është veshi jot, me këtë ti mund të digjosh”
- Përsëriteni këtë dhe pyeteni fëmijën që të tregojë tek veshi juaj. Ndoshta ai thotë edhe fjalën “vesh”.
- Tregoni tek sytë, hunda dhe tek goja, nëqoftëse fëmija i gjen këto pa problem atëherë tregoni edhe tek faqja dhe mjekra.
- Pjesët e fytyrës mundeni ti tregoni edhe në një figurë ose në një kukull

Lavdëroni fëmijën për çfarë ka bërë në regull:

- Po, shumë mirë, ky është një vesh. (Edhe nëqoftëse fëmija se thotë fjalën akoma saktë, ai e digjon fjalën tamam prej jush)

27 Të lozësh me letër



Çfarë mëson fëmija juaj?

- Ai kupton si ndieht letra kur preket dhe çfarë mund të bëhet me të.
- Ai mëson të lëvizi duart qëllimisht
- Ai mëson të dallojë ndryshimet e zhurmave të ndryshme – kjo është mirë për të mësuar gjuhën
- Forma, madhësi, ...

Çfarë ju duhet?

- Për shëmbull: një qese prej letre, një zarf i përdorur, reklama ose një gazetë të vjetër, një fletë letre të bardhë.

ÇFARË MUND TË BËNI?

- Jepjani fëmijës tuaj letrën që ta shikojë atë tamam dhe të kuptojë për çfarë duhet ajo.
- Thoni çfarë është duke bërë fëmija me letrën.
- Tregojini fëmijës dhe gjëra të tjera që ai mund të bëjë me letrën, për shëmbull ta bëj tub dhe ta përdori si megafon ose për të rrëshkitur gjëra të vogla; për të bërë zhurma, për ta grisur, për ta palosur, për ta ngjyrosur, ...
- Bëheni letrën top dhe rotulloheni.

Lavdëroni fëmijën për çfarë ka bërë në regull:

- Provoje dhe ti një herë!
- Sa shumë zhurma që ti bën me letrën.
- Këtë e mendove bukur – edhe kështu shkon!

28 Tavolinë pune



Çfarë mëson fëmija juaj?

- Ti lëvizi krahët, duart dhe gishtat qellimisht
- Ti koordinojë sytë me duart dhe shikimin me lëvizjet
- Ta zgjerojë dhe ta plotësojë fjalorin e tij;
- Të njohi gjëra.
- Vajzat mësojnë njësoj

Çfarë ju duhet?

- Një tavolinë pune

ÇFARË MUND TË BËNI?

- Jepjani tavolinën e punës dhe veglat fëmijës (veglat ndostha një nga një), që ai të lozi me ato.
- Kujdesni që ta lidhni çdo vegël me çdo material.
- Tregojini fëmijës si mund të përdoren veglat dhe materialet, për shëmbull me çekiçin goditen gozhdat.
- Bëheni letrën top dhe ruotulloeni.

Lavdëroni fëmijën për çfarë ka bërë në regull:

- Ti i godet gozhdat shumë bukur!
- Godit njëher fort: BUM! Godit njëher but: tik tik! Shumë mirë!
- Ti po e bën këtë sumë bukur!

29 Të bësh zhurma



Çfarë mëson fëmija juaj?

- Të bëjë lëvizje me gojën: kjo ndihmon që të mësojë të flasi
- Të dëgjosh zhurma dhe fjalë të ndihmon për të mësuar gjuhën
- Të digjojë me vëmendje dhe të imitojë një njeri
- Lidhja e fëmijës me ambientin zhvillohet.

Çfarë ju duhet?

- Nuk ka nevojë për materiale të caktuara.

ÇFARË MUND TË BËNI?

- Uluni përballë me fëmijën tuaj.
- Kërcisni buzët dhe fryni – shikoni nëqoftëse fëmija ju imiton.
- Thoni emrin e një kafeje të njohur. Imitoni zhurmën që bën ajo. Prisni nëqoftëse fëmija juaj e përsërit zhurmën.
- Tregoni gjëra e ndryshme, për shëmbull një makinë, një orë, një ibrik dhe imitoni zhurmat që ato bëjnë. Sigurisht që fëmija do i përsërisi këto zhurma.
- Rotulloni një flet letre, lagrouni pak nga fëmija dhe thoni atij diçka duke e përdorur letrën si megafon.

Lavdëroni fëmijën për çfarë ka bërë në regull:

- Ti qënke në gjëndje të bësh dhe si makinë!
- “Ssssss”, po tamam, kështu bën gjarpri.

30 Të lozësh me copa druri



Çfarë mëson fëmija juaj?

- Ti lëvizi duart dhe krahët qellimisht
- Kontaktet e para me statikën
- Të zhvillojë fantazinë
- Që të koordinojë sytë me duart
- Emrat e ngjyrave të ndryshme

Çfarë ju duhet?

- Copa të vogla druri ose kuti

ÇFARË MUND TË BËNI?

- Jepjani fëmijës copat e drurit ose kutitë dhe lëreni atë që të lozi me to aq sa ai do.
- Shikoeni fëmijën si ai po loz dhe thoni çfarë është duke bërë fëmija.
- Tregojini fëmijës si mund të ndërtohet një kullë me copat e drurit ose kutitë.
- Rëzoheni kullën bashkë me fëmijën tuaj dhe ndërtoheni dhe një herë.
- Krijoni një tren me copat e drurit, duke i vënë ato njëra mbas tjetrës. Fëmija juaj mund ta lëvizi këtë tren duke i shtyrë copat.
- Vijini copat e drurit simbas ngjyrave njëra mbas tjetrës ose anash tjetrës.

Lavdëroni fëmijën për çfarë ka bërë në regull:

- Sa kullë të lartë që ti ndërtove.
- Për trenin tënd ti zgjodhe një ngjyrë të bukur.

31 Të tregosh diçka për kafshët



Çfarë mëson fëmija juaj?

- Të njohë kafshët e ndryshme
- Të digjojë tamam
- Të shikojë figura
- Të njohi libra

Çfarë ju duhet?

- Një libër me piktura të kafshëve
- Kafshë prej lecke

ÇFARË MUND TË BËNI?

- Fëmija juaj mund të mbajë një libër dhe ta shikojë atë.
- Ju mund të tregoni një kafshë edhe të thoni çfarë ka kjo kafshë të veçantë.
- Pyeteni fëmijën “Ku është lopa? Ma trego mua. Në regull, tashti kalin.”
- Ju mund të bëni zhurmat që bëjnë kafshët dhe ta pyesni fëmijën “Si bën lopa? Si bën kali?”.
- Nëqoftse fëmija juaj është dy ose tre vjeç ju mund ti tregoni atij diçka për kafshët: “Një gomar është i fortë dhe mundet të mbajë pesha të mëdha. Një mace është e vogël dhe ka lëkurë të butë.”
- Nëqoftse fëmija nuk e thotë një fjalë tamam, ju mund ta përsërisni këtë në një fjali të plotë.
- Nëqoftse fëmija thot për shëmbul “maçi”, atëhere thoni “Po, atje po vrapon një mace e zezë”. Mos e korigjoni direkt.

Lavdëroni fëmijën për çfarë ka bërë në regull:

- Po ky është një qen, ti e tregove këtë në regull.
- Ti i imiton shumë mirë kafshët.

32 Vrapo, Can – vrapo, Gül



Çfarë mëson fëmija juaj?

- Fjalët, tingullin dhe ritmin e gjuhës
- Të kërkojë diçka që ka humbur: është mirë për
- ndjenjën e orientimit

Çfarë ju duhet?

- Një labustil ose një laps me ngjyrë me majë të lagur.

ÇFARË MUND TË BËNI?

- Vizatoni tek gishti tregues i çdo dore një fytyrë.
- Tregojani fytyrat fëmijës tuaj dhe thoini atij që “ata quhen” njëri Can dhe tjetri Gül edhe që ata dinë të vrapojnë. “Më dëgjo mua mirë!”

Po vraponin njëherë dy njëres	trokisni me “Can” dhe “Gül” në Tavolin
Lart në mal, si po shikon	
Njëri quheshe Can	ngrini një gisht
Dhe tjetri quheshe Gül	ngrini gishtin tjetër
Vrapo, Gül!	fshihni “Gülin” mbrapa kurizit
Vrapo, Can!	fshihni “Canin” mbrapa kurizit
Hajde mbrapsht, Can!	ngriheni gishtin prapë lart
Hajde mbrapsht, Gül!	ngriheni gishting tjetër prapë lartë

- Përsëritini këto vargje. Mbasi kini fshehur “Canin” dhe “Gülin” pyeteni fëmijën: “ku është Cani? Ku është Gül?”

Lavdëroni fëmijën për çfarë ka bërë në regull:

- Ti je shumë i vëmëndshëm, Cani dhe Güli janë mbrapa kurzit tim.

33a Të zbërthesh një puzzle



Çfarë mëson fëmija juaj?

- Të kapi gjëra me gishtin e madh dhe gishtin tregues saktësisht
- Të koordinojë sytë dhe duart
- Të kontrollojë duart e veta
- Ti shikojë figurat me më shumë vëmendje

Çfarë ju duhet?

- Një puzzle me pjesëza të mëdha

ÇFARË MUND TË BËNI?

- Në fillim lëroni fëmijën të lozi me puzzlen i lirë.
- Mbas një farë kohe ju mund të tregoni pjesët e puzzles dhe te thoni diçka për to.
- Ju mund ti thoni fëmijës që tju tregojë dhe ai ca nga pjesët e puzzles.
- Tregojini fëmijës si ai mund të zbërthejë një pjesë nga puzzlja
- Fëmija juaj normalisht do e përsërisi vetë këtë, nëqoftëse ai nuk e bën këtë atëhere i thoni që ai të heqi një pjesë
- Ju mund të bëni the zhurma me pjesët duke i trokitur ato me njëra tjetrën.

Lavdëroni fëmijën për çfarë ka bërë në regull:

- Po tamam, po ta kthesh puzzlen atëhere të tëra pjesët bien.
- Sa bukur që ti i zbërthen pjesët.

33b Të formosh një puzzle



Çfarë mëson fëmija juaj?

- Të kërkojë forma që shkojnë me njëra tjetrën, kjo është e rëndësishme për zhvillimin mendor
- Ti lëvizni duart dhe gishtat qëllimisht
- Lëvizja e koordnuar e gishtit tregues dhe gishtit të madh
- Të shikojë forma, ngjyra dhe figura të ndryshme me më shumë vëmendje

Çfarë ju duhet?

- Nëqoftse fëmija juaj është një vjeç: një puzzle me pjesë të mëdha
- Nëqoftse fëmija juaj është më i madh: një puzzle normale, në fillim me katër copa

ÇFARË MUND TË BËNI?

- Flisni me fëmijën për figurat tek pjesët e puzzles.
- Merni dy pjesë të puzzles.
- Tregojini fëmijës si mund të lidhen dy pjesët e puzzles; të gjejë vendin që i shkon, ti rutulohet dhe ti shtyjë gjeri sa ato të hynë tek njëra tjetra.
- I thoini fëmijës ta fusi ai një pjesë tek puzzleja (nëqoftse ai nuk arin ta bëjë këtë, atëherë ndihmoheni).
- Ndihmoheni fëmijën me duar edhe fjalë, për shembull “Rutullohe pjesën, edhe një çik më shumë, një çik mbrapsht, tamam kështu!”
- Nëqoftse fëmija juaj nervozohet se nuk po arin ti bashkojë pjesët atëherë qetsoheni atë edhe jepini atij një pjesë më të thjeshtë.

Lavdëroni fëmijën për çfarë ka bërë në rregull:

- Ti e vure pjesën tamam në vendin e saktë.

34 Të hecësh mbi këmbët e tjetrit



Çfarë mëson fëmija juaj?

- Të kooprojë
- Të mbajë ekuilibrin

Çfarë ju duhet?

- Nuk ka nevojë për materiale

ÇFARË MUND TË BËNI?


- Vëreni fëmijën mbi këmbët tuaja dhe ecni kështu.
- Hecni njëher avash njëher shpejt dhe thoni “avash” dhe “shpejt” .
- Bëni njëherë hapa të mëdha dhe njëher hapa të vogla dhe thuajeni këtë.
- Imitoni mënyrat e të hecurit të kafshëve: Ti hedhësh këmbët si pata ose të kërcesh si kali.
- Lëreni fëmijën që të heci dhe nga ana tjetër, që ju të dy të shikoni në një drejtim
- Ju mund të thoni këtë vjershë:

Një këmbë, dy këmbë, tralala
një këmbë, dy këmbë po hecnin në bar,
një këmbë, dy këmbë po hecnin në rugë,
deri sa fëmija u rit.

Lavdëroni fëmijën për çfarë ka bërë në regull:

- Sa hapa të mëdha që ti bën! Sa hapa të shpeta që ti bën! Sa mirë që ti di të hecësh mbrapsht!

35 Të ngjisësh



Çfarë mëson fëmija juaj?

- Ushtron lëvizjen e duarve
- Të dëgjosh zhurma dhe fjalë të ndihmon për të mësuar gjuhën
- Bashkpunimin e duarve me sytë
- Si ta përdori ngjitësin
- Të zhvillojë ndjenjën e prekjes

Çfarë ju duhet?

- Gazeta të vjetra për mbulesë
- Letra që të mund të grisen
- Një letër e fortë
- Një ngjitës në formë lapsi

ÇFARË MUND TË BËNI?

- Tregojini fëmijës gjërat dhe i thoni atij emtrat e atyre.
- Tregojini fëmijës tuaj si mund të griset letra.
- I thoni fëmijës ta grisi letrën.
- Tregojini fëmijës si të punojë me ngjitësin.
- I thoni fëmijës të vëri ngjitës tek copat e letrës.
- Ngjitini bashkë pjesët e letrës së grisur tek letra e fortë, dhe flisni për veprimet që po bëni.

Lavdëroni fëmijën për çfarë ka bërë në regull:

- Ti e gris letrën bukur! Sa fort që e shtyp ti! Sa butkur që e ngjite këtë.

36 Të frysh topat



Çfarë mëson fëmija juaj?

- Të preceptojë frymariën
- Të bëjë diçka tjetër me frymën e tij
- Të lëvizë muskujt e gojës, që të mësojë të flasi në regull
- Të lëvizë gjuhen dhe buzët qëllimisht
- Të bëjë diçka bashkarisht, të lozi me të tjerë

Çfarë ju duhet?

- Një top pingpongu ose një top prej pambuku
- Nëqoftëse bëhet dy kallama
- Nëqoftëse bëhet një pasqyrë

ÇFARË MUND TË BËNI?

- Jepini topin fëmijës që ai ta shikojë, ta preki dhe ta njohi atë.
- Tregoini fëmijës çfarë do bëni me topin.
- Fryeni topin mbi tavolinë në dretimin e fëmijës tuaj.
- I thoni fëmijës që edhe ai ta fryjë topin.
- Nëqoftëse ai arin ta bëjë këtë atëhere hidhjani topin njëri tjetrit duke e fryrë.
- Mund të përdorni edhe një kallam për ti fryrë topit
- Shikoni veten tuaj në pasqyrë kur i fryni topit

Lavdëroni fëmijën për çfarë ka bërë në regull:

- Ti mund të frysh shumë fort!
- Sa larg që ti e fryn topin!

37 Të lozësh si blihet në dyqan



Çfarë mëson fëmija juaj?

- Të kopjojë të lozi situacione të njohura
- Të lozi bashkarisht
- Shumë fjalë dhe fjali të reja

Çfarë ju duhet?

- Një çantë ose qese
- Kuti qumështi, kuti kosi, kuti (të tëra bosh)
- Një portofol të vjetër
- Për “monedha” mund të përdorni komça, lekë plastike ose cente

ÇFARË MUND TË BËNI?

- Jepini fëmijës njëra mbas tjetrës gjërat që janë për tu blerë.
- Mereni qesen dhe lekët dhe ftojini fëmijën tuat të lozi: “Mirë dita, und dua të blë diçka këtu tek ju. Mund të me jepni një litër qumësht?”
- Nëqoftse ka nevojë, ndimoeni fëmijën në rolin e tij të shitësit: “Tashi ma jep qumështin dhe thuaj: ‘Një euro të lutem’.”
- Ju mund të blini dhe gjëra të tjera, ti fusni ato në qese dhe ti paguani.
- Tregoeni veten si një klient fjalëplot dhe thoni diçka për gjërat.
- Ndroni rolet, ndoshta do dhe fëmija juaj që ta lozi klientin

Lavdëroni fëmijën për çfarë ka bërë në regull:

- Ti di ti bësh mirë pazaret!
- Ti je një shitës i mirë!
- Sa shumë që ti shite tashi!

38 Të sistemojmë lodrat së bashku



Çfarë mëson fëmija juaj?

- Të bëjë diçka bashkë me të tjerë
- Koordinimin e syve dhe duarve bashkarisht
- Të mbajë ambientin reth e rotull tij në regull

Çfarë ju duhet?

- Disa kuti për lodrat
- Lodra që janë rëmuje

ÇFARË MUND TË BËNI?

- Jepini fëmijës kutitë për lodrat dhe shikoni çfarë ai bën me to.
- I Thoni fëmijës tuaj që ato janë kuti për lodrat dhe që bashkarisht do i fusni të tëra lodrat brënda.
- Jepini fëmijës lodra të një tipi të caktuar (për shëmbull pjesë egoje ose duploje) dhe i thoni atij që ti fusi ato në një kuti.
- Nëqoftse fëmija juaj është më i vogël se 6 vjeç atëhere ai ka nevojë që ta ndimoni.
- Tregoheni veten si një klient fjalëplotë dhe thoni diçka për gjërat.
- Përdorni për një tip lodre tjetër (për shëmbull me copa dërrase) një kuti tjetër

Lavdëroni fëmijën për çfarë ka bërë në regull:

- Në cilën kuti do i fusim makinat? Në këtë? Kjo është një ide e mirë, kështu do e bëjmë këtë! Ti e bën këtë shumë mirë!
- Sa bukur që ti i rendit lodrat e tua!

39 Hop, hop, hop – Hec kali me galop



Çfarë mëson fëmija juaj?

- Të lozi bashkë një lojë
- Tingullin e ritmin e një gjuhe dhe të fjalve të saj

Çfarë ju duhet?

- Nuk ka nevojë për materiale

ÇFARË MUND TË BËNI?

- Mereni fëmijën tuaj në prehr dhe tundini gjunjët pak lartë e poshtë: “Do të hecim me kalë?”.
- Kapeni fëmijën poshtë krahëve dhe mbaheni fort.
- Tundini që të dy gjunjët, një herë më shpejt një herë më avash: “Hop, hop, hop – hec kali me galop!”.
- Ngriheni fëmijën lart tek fjala e fundit.
- Pastaj uleni prapë shpejt tek gjunjët tuaj.
- Mund të këndonni këto vargje:

Hop, hop, hop – hec kali me galop!
 Mbi gurë dhe drasa,
 Por kujdes mos thyesh këmbët,
 hop, hop, hop – hec kali me galop!

Lavdëroni fëmijën për çfarë ka bërë në regull:

- Ti di ta mbash veten tënde fort!
- Sa bukur që ti e loz kalorësin!

40 Të lozësh me plastelinë



Çfarë mëson fëmija juaj?

- Të ndjejë dhe të lëvizi gishtat në një mënyrë të re.
- Mëson të njohi një material të ri, që mund ta formojë vetë.

Çfarë ju duhet?

- Plastelinë në një ngjyrë – më vonë ju mund të përdorni edhe më shumë ngjyra
- Një shtresë për ta vënë poshtë plastelinës, për shëmbull një karton ose pjatë plastike


ÇFARË MUND TË BËNI?

- Jepini plastelinën fëmijës tuaj që ta njohi materialin.
- Merni vetë një copë plastelinë dhe formoni për shëmbull një kek të ulët, një gjarpër të gjatë, makarona ose topa.
- Kujdesuni çfarë fëmija është duke bërë dhe tregoni diçka për veprimet e atij, për shëmbull “Ti mer copa shumë të vogla dhe i bashkon ato më njëra tjetrën, shumë mire!”
- Tregoni që me gishtat mund të hapni vrima në plastelinë
- Tregoni që me bishtin e një luge ose me thonjtë e gishtave mund të bëni viza tek plastelina.

Lavdëroni fëmijën për çfarë ka bërë në regull:

- Ti di ta përdorësh plastelinën shumë mirë!
- Sa bukur që ti e formon topin/gjarprin/... !

41 Të bësh si tren



Çfarë mëson fëmija juaj?

- Të bëjë diçka bashkarisht:
- Kjo është e rëndësishme që të ushtrojë bashkëpunimin me të tjerët.
- Të bëjë gjoja sikur; Kjo shvillon fantasinë dhe mundësinë për të provuar aftësitë e tij.

Çfarë ju duhet?

- Hapësirë e bollshme për të lëvizur

ÇFARË MUND TË BËNI?

- Mereni foshnjen në krahë/vëreni fëmijën 2 ose 3 vjeç mbrapa kurizit tuaj dhe i thoni atij që të mbahet tek ju.
- Filloni të hecni dhe i thoni fëmijës që do bëni si tren: “E dëgjon: çuf, cuf, çuf, ...”
- Filloni të hecni gjithnjë e më shpejt si një tren që është duke u nisur.
- Bëni edhe sikur po i bini buries: “Tyyty, tyyyyyyy!”
- Lëreni edhe fëmijën që të lozi një herë lokomotivën, të heci përpara, të mari kthesën dhe ti bieri buries.
- Mundet dhe të këndoni një këngë trenash për fëmijët:

Tren gelir, hos gelir

Eine Insel – Lummerlandlied (gjermanisht dhe turqisht)

Tren gelir, hos gelir

Eine Insel – Lummerlandlied (gjermanisht dhe turqisht)

- Për të bërë këtë mund të rjeshtoni dhe disa karige
- Lavdëroni fëmijën për çfarë ka bërë në regull:

- Ti e bën trenin shumë mirë!

42 Ti shkosh ruazat në pe



Çfarë mëson fëmija juaj?

- Të lëvizi duart me saktësi
- Bashkpunimin e duarve dhe syve

Çfarë ju duhet?

- Ruaza të mëdha, pe, spango ose lidhse këpucëve

ÇFARË MUND TË BËNI?

- Lëreni fëmijën të lozi me pe dhe me ruazat.
- Futeni ruazën e parë tek peri dhe kopsiteni atë.
- Tregojini fëmijës si ta kalojë perin nga ruaza.
- Ngrieni perin lartë që ruazat të bien poshtë
- Mbaheni perin dhe thoni fëmijës të kalojë një ruazë
- Thuajini fëmijës që ta mbajë ai perin edhe të kalojë një ruazë

Lavdëroni fëmijën për çfarë ka bërë në regull:

- Kështu është mirë, ti po e mban perin mirë!
- Sa bukur që ti i kalon ruazat!

43 Të bësh një kollotumba



Çfarë mëson fëmija juaj?

- Të kontrollojë trupin e tij
- Të lëvizë qellimisht

Çfarë ju duhet?

- Një shtresë e butë për në tokë

ÇFARË MUND TË BËNI?

- Në qoftse e ndjeni veten në gjendje dhe doni, bëni një kollotumbë.
- Lëreni fëmijën të ulet në gjunjë dhe të mbahet me duart në tokë.
- Ndhimoheni fëmijën ta fusi kokën në mes të duarve të tij dhe mbajani qafën me një dorë.
- Ndhimoheni me dorën tjetër ta ngrejë prapnicën e tij dhe pastaj që ta mbarojë rutulimin.
- Lëreni fëmijën që ta provojë një herë vetë, ndimoheni vetëm pak.
- Nëqoftse fëmija juaj nuk to ta bëjë këtë lojë ju mund të luani një lojë më të thjeshtë: këndon diçka dhe në fund shtriuni në dysHEME dhe rotullouni.

Lavdëroni fëmijën për çfarë ka bërë në regull:

- Sa bukur që ti rotulloesh!
- Ti i bën kollotumbat shumë bukur!

44 Një lojë me gishta



Çfarë mëson fëmija juaj?

- Të shikojë tamam dhe me vëmëndje
- Ritmin dhe tingullin e një guhe dhe fjalve të saj:
- Kjo është një përgatitje e mirë për të mësuar që të flasësh

Çfarë ju duhet?

- Një labustil ose një laps me ngjyrë me majë të lagur

ÇFARË MUND TË BËNI?

- Ju mund të vizatoni fytyra tek majat e gishtave tuaj ose tek thonjtë.
- Lëreni fëmijën të lozi me gishtat tuaj, ju mund të thoni këto vargje gjatë kësaj kohe:

Pesë bura hynë në pyll dhe deshnin të kapnin një lepur.
I pari, ai ishte i trashë sa një fuçi, ai bërtiste gjithmonë "ku është lepur?"
I dyti thëriste: "Atje po vrapon ai!"
I treti, që ishte i gjatë, kishte aq frikë, sa filloi të qante: "Unë nuk po shikoj ndo një gjë!"
I katërti tha: "Mua mu mërzit, unë po kthehem mbrapsht!"
Më i vogëli ama, kujt ja mori mëndja, e solli lepurin në shtëpi.
Me këtë rast të gjithë njerzit qeshën "Hahahahaha!"

Texte të tjera të thjeshta janë:
"Zehn kleine Zappelmänner" ("Dhjetë gishta të vegjël")
"Das ist der Daumen" ("Ky është gishti i madh")

- Nëqoftse fëmija juaj është 1 ose 2 vjeç, ju mund ti palosni gishtat e fëmijës njëri mbas tjetrit duke thënë vargjet.

Lavdëroni fëmijën për çfarë ka bërë në regull:

- Po tamam ky është gishti jot i madh!

45 Libra me figura



Çfarë mëson fëmija juaj?

- Të shikojë piktura
- Të dëgjojë kur i tregohet një gjë: Kështu ai mëson gjuhën.
- Të mësohet me figurat.

Çfarë ju duhet?

- Një libër me figura

ÇFARË MUND TË BËNI?

- I jepini librin fëmijës dhe bëni kujdes çfarë ai bën me të, i thoni diçka për veprimet e tij.
- Thoni diçka në gjuhën tuaj, për pikturat në libër edhe tregoni tek ato.
- Lëreni fëmijën tuaj që ti kthejë faqët e librit.
- Nëqoftse fëmija juaj nuk e thotë në regull një fjalë, atëhere përsëriteni fjalën dhe njëherë në një fjali të plot. Për shëmbul fëmija juaj thotë “aiu” për një “ari”, atëhere thoni: “Po, ky është një ari!”

Lavdëroni fëmijën për çfarë ka bërë në regull:

- Të shikosh figura me ty bën qef!
- Sa bukur që tregon ti për figurat!

46 Të pikturosh me Bojra uji



Çfarë mëson fëmija juaj?

- Ushtron lëvizjet e duarve
- Koordinimin e duarve dhe syve; Kjo është e rëndësishme për të mësuar që të shkruash.
- Të shprehet.

Çfarë ju duhet?

- Një penel i gjërë e petashuq dhe letra që thithin ujin (fleta të mëdha, ose letra (tapete) muri)
- Një ose dy ngjyra në goda të cekta (që nuk rëzohen kollaj)
- Një sfingjer të lagur
- Një picetë ose qese plastike për ta shtruar nga poshtë dhe një qese plastike të madhe për ta prerë ose një këmishë të vjetër (që ta veshi fëmija që mos bëjë robat pisë)

ÇFARË MUND TË BËNI?

- Vishjani qesen ose këmishën fëmijës dhe i thoni atij që tashti do vizatoni me bojra uji (thoni dhe emrin e ngjyrave).
- Vëreni letrën mbi shresën (picetën ose qeskën) dhe lageni sfingerin mirë.
- Jepjani peneli fëmijës tuaj dhe i tregoini atij ngjyrat ("Ti mund të pikturosh me këtë ngjyrë.").
- Në fillim fëmija mund të ngjyëjë gishtin ose dorën dhe të lerë gjurmën e tyre tek letra.
- Tregojini fëmijës si ta ngjyëjë penelin tek boja.
- Tregojini atij si të bëjë pika the viza tek letra.
- Shikoni me fëmijën tuaj si përhapet ngjyra tek letra.
- Pikturoni edhe vetë diçka dhe i thoni fëmijës tju imitoj
- Mund të merni edhe një ngjyrë të dytë (thoni emrin e ngjyrës)

Lavdëroni fëmijën për çfarë ka bërë në regull:

- Ti pikturon shumë bukur!

47 Lloto me figura



Çfarë mëson fëmija juaj?

- Të lozi bashkarisht simbas regullave
- Fjalë të reja
- Gjëra të ndryshme dhe të përbashkta

Çfarë ju duhet?

- Një lloto me figura

ÇFARË MUND TË BËNI?

- Shikoni bashkë me fëmijën tuaj figurat dhe thoni çfarë ato tregojnë.
- Gjeni cilat figura shkojnë me njëra tjetrën edhe pse.
- Ju dhe fëmijaj juaj mund të merrni secili një nga tabelat e lojës.
- Merrni një nga kartat me figura dhe vëreni tek figura që i shkon tek tabela e juaj. Nëqoftëse nuk ka ndonjë figurë që i shkon, atëherë vëreni kartën anash.
- Kur ti vini kartat, vëreni ato me fytyrë nga poshtë.
- Mëpas merrni simbas radhës një kartë dhe vëreni në vëndin e saj tek tabela juaj.

Lavdëroni fëmijën për çfarë ka bërë në regull:

- Ti e kupëtove këtë tamam: Karigia e ka vëndin tek tabela jote.

48 Të Ndjeje



Çfarë mëson fëmija juaj?

- Të ndjejë saktë me duartë e tij
- Të mësojë, çfarë ndjen

Çfarë ju duhet?

- Disa gjëra të njohura:
- gjëra të ftohta/të ngrohta
- gjëra të buta/të forta
- gjëra të lëngshme/të forta

ÇFARË MUND TË BËNI?

- Lëreni fëmijën në fillim ti preki dhe ti shikojë të tëra gjërat.
- Flisni për materialet: janë ato të buta ose të forta, të lëmuara ose me grënçka, të ftohta ose të ngrohta, janë të rënda ose të lehta?
- Tashti çdo njëri i fut duart poshtë tavolinës.
- Jepini fëmijës poshtë tavolinës një gjë.
- I thoni fëmijës që të tregojë si ndihet kjo gjë.
- Pastaj mundet t'ju japi fëmija juaj ju një gje edhe ju duhet të përshukani si ndihet kjo gjë.
- Kështu vazhdon loja, një radhë njëri dhe një radhë tjetri.

Lavdëroni fëmijën për çfarë ka bërë në regull:

- Sa bukur që ti i analizon gjërat.
- Po, tamam, guri është i ftotë.
- Po, tamam, puloveri është i butë.

49 Lojë me të veshura



Çfarë mëson fëmija juaj?

- Të bëjë sikur është një njeri tjetër
- Të shvillojë fantasinë

Çfarë ju duhet?

- Një copë leckë e butë, për shëmbull një shall

ÇFARË MUND TË BËNI?

- Lëreni fëmijën të lozi me leckën si ai do.
- Pyeteni fëmijën si e ndjen leckën edhe çfarë ngjyre ajo ka.
- Lëreni fëmijën të provojë vetë çfarë mund të bëjë me leckën edhe mos i thoni ndo një gjë.
- Tregojini atij si përdoret leckë si përparëse, shami koke, kapele, fasho ose batanije.
- Ndihmoheni fëmijën ta lidhi edhe ta bëjë nyje leckën.
- Lëreni fëmijën ta shikojë veten në pasqyrë.
- Kur fëmija është duke e mbajtur reckën si përparse ju mund të bëni sikur ai është një guzhinjer dhe pyeteni çfarë ai do që të gatuajë.

Lavdëroni fëmijën për çfarë ka bërë në regull:

- Ti e mendove këtë mire, tashti leckë është një batanije!

50 Kala me gota



Çfarë mëson fëmija juaj?

- Të lëvizi krahët dhe këmbët qellimisht
- Koordinim e syve dhe duarve
- Kuptimin e fjalëve: mbi, brënda, anash, mbrapa, përpara
- Të dallojë ngjyrat dhe t'ju a thotë emrin atyre

Çfarë ju duhet?

- Kala me gota / Kukulla brënda kukullave (Matrjoshka)

ÇFARË MUND TË BËNI?

- Shikoni si fëmijaj juaj është duke luajtur me gotat dhe thoni çfarë po bën ai.
- Verini gotat njëra MBI tjetrën, thoni fjalën MBI me zë më të lartë.
- I thoni tashti fëmijës ti vëri gotat njëra MBI tjetrën, nëqoftse ai nuk e bën këtë tregojani edhe njëherë.
- Aq kohë sa fëmijës i pëlqen ju mund ti përsërisni këto veprime duke i shoqëruar me fjalët BRËNDA, POSHT, ANASH dhe MBRAPA.
- Nëqoftëse fëmijës i pëlqen më mirë që të lozi vetë me gotat lejoheni. Thoni ama gjithmonë çfarë ai është duke bërë: "E shikon, tashti ti e fute gotën e kuqe BRËNDA tek gota e verdhë."
- Thoni gjithmonë edhe emrin e ngjyrave të gotave që fëmija ti mësojë këto fjalë.

Lavdëroni fëmijën për çfarë ka bërë në regull:

- Ti i vë gotat shumë mirë njëra sipër tjetrës. Tashti unë do ti vë ato njëra anash tjetrës, di ta bësh edhe ti këtë?

51 Të ndihmosh në shtëpi



Çfarë mëson fëmija juaj?

- Të ketë besim tek vetvetja
- Të punojë autonom
- Zhvillon besimin që di të bëjë një gjë

Çfarë ju duhet?

- për shëmbull kapse dhe roba të lagura; Ushqime të blera që duhet të vien në vënd, Patate që duhet të qërohen; gota plastike që duhet të shplahen

ÇFARË MUND TË BËNI?

- Mendohuni në cilat aktivitete mundet që tju ndimojë fëmija.
- Mendoni një situacion në të cilën fëmija mund t'ju ndihmojë juve, për shëmbull: ti nxjeri gjërat e blera nga qesja dhe ti vëri në vënd, T'ju japi kapset me të cilat të kapni robat e nderura, të vëri patatet e qeruara në një tenxhere e të trazojë gjellën një një tenxhere.
- Ju mund ta pyesni fëmijën tuaj: “Do ti të më ndimosh mua?” “Do më japësh ti mua një kapse?”
- Shtroni bashkë me fëmijën tuaj tavolinën.
- Flisni me fëmijën tuaj për veprimet që po bëni: “Çfarë do bëjmë me gjërat e blera?” “Pse po i varim ne robat?”

Lavdëroni fëmijën për çfarë ka bërë në regull:

- Ti më ndihmove shumë, shumë falemderit!

52 Unë shoh çfarë ti nuk shikon



Çfarë mëson fëmija juaj?

- Të shikojë tamam
- Ndryshimet tek ngjyrat
- Fjalë të reja, për shëmbull emrat e ngjyrave dhe të gjërave

Çfarë ju duhet?

- Nuk ka nevojë për materiale

ÇFARË MUND TË BËNI?

- I thoni fëmijës t'ju tregojë të tëra gjërat me një ngjyrë të caktuar që shikon në dhomë; kështu do kuptoni se ai e njeh atë ngjyrë.
- Shikoni një gjë të KUQE në dhomë dhe i thoni fëmijës “Unë shoh çfarë ti nuk shikon edhe ajo është e KUQE.”.
- Lëreni fëmijën që ta gjejë për çfarë ju e kishit fjalën. I thoni “ngroht” nëqoftëse është afër asaj për të cilën ju e kishit fjalën. I thoni “ftoht” nëqoftëse fëmija është larg asaj gjëje.
- Më pas të zgjedhi fëmija një gjë dhe ti thotë asaj ngjyren dhe ju duhet të gjeni për çfarë ai e kishte fjalën.
- Tashi zgjidhni një gjë prej një materiali të caktuar, për shëmbull prej druri ose xhami: “Unë shoh çfarë ti nuk shikon edhe ajo është prej druri.”
- Fëmija juaj mund të tregojë ose të thotë çfarë është ajo gjëja.

Lavdëroni fëmijën për çfarë ka bërë në rregull:

- Ngroht! Ti pothuajse e gjetë!
- Sa mirë që ti e gjetë!

53 Memory (Kujtesa)



Çfarë mëson fëmija juaj?

- Fjalë të reja
- Të dallojë ndryshime dhe gjëra të përbashkta
- Të mbajë mend një gjë
- Të lozi bashkarisht si mbas regulave

Çfarë ju duhet?

- Në fillim katër palë karta memory dhe pastaj më shumë!

ÇFARË MUND TË BËNI?

- Shikoni bashkë me fëmijën tuaj kartat edhe pyeteni çfarë ato tregojnë.
- Vërin kartat me fytyrë nga lart dhe kërkon gjithmonë një palë karta që shkojnë bashkë.
- Nëqoftse fëmija e kupton këtë atëhere shikoni cilat karta shkojnë edhe me kartat e tjera (për shëmbul molla edhe kumbulla shkojnë me njëra tjetrën se janë që të dyja fruta; Karigia dhe tavolina shkojnë bashkë se janë që të dyja mobilije).
- Tashi kthehni kartat me fytyrë nga poshtë.
- Ndimoheni fëmijën tuaj që ti ngatërojë kartat.
- Tashti ktheni gjithmonë një palë karta, nëqoftse ato nuk shkojnë me njëra tjetrën kthehni ato prapë mbrapësht, ose për ndryshe vijini ato anash.
- Në qoftse njëri gjen dy karta që janë njësoj atëhere ai mund ti mbajë ato dhe të kthejë dy karta të tjera.

Lavdëroni fëmijën për çfarë ka bërë në regull:

- Po ke të drejtë, ato ty karta shkojnë bashkë!

54 Të lozësh përjashta me rërë



Çfarë mëson fëmija juaj?

- Si ndihet rëra edhe çfarë mund të bësh me atë
- Të bëjë diçka prej rëre
- Ti japi konkretizojë fantasis të vet

Çfarë ju duhet?

- Një arkë e madhe me rërë afër vëndit ku banoni
- Pak rërë të bardhë afër shtëpisë ose në ballkon
- Një kovë të vogël me ujë

ÇFARË MUND TË BËNI?

- Vishini fëmijës roba që sprish punë po të bëhen pisë.
- Lëreni fëmijën të lirë të lozi me rërën dhe me ujin (Shum fëmijë e hedhin me qef ujin tek rëra ose rërën tek uji).
- Inkurajoheni fëmijën duke i qeshur atij ose duke e tundur kokën.
- Flisni me fëmijën si ndihet rëra (e lagur, e thatë, kokra kokra, e imët, e butë,...).
- Ndërtoni diçka bashkë me fëmijën tuaj, për shëmbull një kek ose një mal me tunel, ...
- Mbasi të mbaroni regullojini prapë gjërat bashkë me fëmijën tuaj, për shëmbull futeni rërën që u derdh prap në arkën me rërë.

Lavdëroni fëmijën për çfarë ka bërë në regull:

- Ti poqe një kek shumë të mirë!

55 Ta rotullosh topin dhe të marësh shënjë



Çfarë mëson fëmija juaj?

- Të kontrollojë lëvizjet e krahve, duarve dhe gishtave
- Bashkpunimin e syve, krahve dhe duarve
- Mënyra të ndryshme për të hedhur topin
- Të lozi bashkarisht

Çfarë ju duhet?

- Një top të lehtë dhe të butë.

ÇFARË MUND TË BËNI?

- Tregojani fëmijës topin edhe flisni për formën, butësinë dhe peshën e atij.
- Lëreni fëmijën të provojë çfarë mund të bëhet me topin.
- Ju mund t'ja jepni topin njëri-tjetrit në mënyra të ndryshme (ta hidhni, ta rotulloni, ta shtyni).
- Kërkoni një shënjestër të madhe, për shëmbull një derë. Pastaj mund të zgjidhni edhe shënjestra më të vogla si poshtë një karigeje midis këmbve.
- Nëqoftse kjo s'ishte e vështirë mund të provoni edhe një këmbë të tavolinës ose gjëra të tjera të vogla si një gotë plastike.

Lavdëroni fëmijën për çfarë ka bërë në regull:

- Ti e rotullon topin shumë mire, dhe godet tamam në shënjë!

56 Dëgjo tamam edhe kërko



Çfarë mëson fëmija juaj?

- Të dëgjojë tamam

Çfarë ju duhet?

- Një dhomë pa televizor ose radio të ndezur.
- Një orë që bën tik tak ose një gjë tjetër që bën zhurmë.

ÇFARË MUND TË BËNI?

- Imitoheni zhurmën e orës edhe këndoni bashkë një këngë për atë.

Orët e mëdha bëjnë tik – tak, tik – tak,
orët e vogla bëjnë tike – take, tike – take,
dhe orët e vogla të xhepit tike – take, tike – take, tik.

- I thoni fëmijës që ti mbylli sytë gjatë kohës që ju mshefni orën.
- I thoni fëmijës që ta gjejë orën duke hecur reth e rotull dhe duke dëgjuar me vëmëndje.
- Nëqoftse fëmija do, atëhere mundet ai ta mshefi orën pastaj dhe ju ta gjeni

Lavdëroni fëmijën për çfarë ka bërë në regull:

- Ti e dëgjove tamam dhe e gjete shumë mirë orën!

57 Të mësosh të vishesh



Çfarë mëson fëmija juaj?

- Të bejë diçka vetë, pa ndihmën e të tjerëve
- E ndjen vetën të ritur dhe zhvillon vetëbesimin e tij.

Çfarë ju duhet?

- Roba të ndryshme

ÇFARË MUND TË BËNI?

- Ushtroni veshjen e robave të ndryshme për shëmbul mbas dushit (kanatjeren / këmishën / pulovërin / çorapet / ...).
- Ushtroni që të kopsitni këmishen apo që ta hapni dhe mbyllni zinxhirin e pantallonave ose të xhupit.
- Vëreni në tokë xhupin e hapur me pjesën e qafës në drejtimin tuaj edhe zinxhirin nga sipër.
- Ndimoheni fëmijën ta veshi xhupin dhe ti fusi duart.
- Nga pas tërhiqeni xhupin poshtë, në mënyrë që ti rijë fëmijës në regull.
- Ushtroni aq kohë sa fëmija do.
- Pastaj vëreni xhupin në një tavolinë të ulët.
- Tregojini fëmijës tashti si ta hapi dhe ta mbylli xhupin.
- Inkurajoheni fëmijën nëqoftëse ai mundohet por nuk arin ta bëjë një gjë tamam. Ndimoheni atë pak dhe inkurajoheni: “Provoje dhe një herë!”

Lavdëroni fëmijën për çfarë ka bërë në regull:

- Ti e bërë shumë mirë!

58 Të bësh vetë një puzzle



Çfarë mëson fëmija juaj?

- Ti përdori muskujt e duarve edhe të gishtave për një qëllim
- Koordinimin e syve dhe duarve
- Të mendojë për forma
- Ti bashkojë pjesët e një figure

Çfarë ju duhet?

- Një figurë, kartoni të hollë dhe ngjitës ose një kartolinë
- Një gërrshërë për fëmijë

ÇFARË MUND TË BËNI?

- Kërkoni një figurë që i pëlqen fëmijës dhe i flisni atij për të: “Çfarë shikon ti këtu? Çfarë të pëlqen ty?”
- Lyeni kartonin me ngjitës nga njëra anë dhe ngjiteni figurën fort tek ai.
- I tregoni fëmijës që prej figurës do bëhet një puzzle dhe që ju do e prisni atë.
- Lëreni fëmijën që ta presi atë në dy pjesë. Nidomoheni atë – nëqoftse ka nevojë – duke i drejtuar atij duart.
- Tashti lëreni fëmijën ti bashkojë pjesët. Nëqoftëse nuk është problem, atëhere lëreni atë ta presi çdo pjesë edhe një herë dhe ti bashkojë që të katërta pjesët.
- Ndhimoheni atë nëqoftëse ai nuk i bashkon dot pjesët, për shëmbul duke i vënë pjesët njëra mbi tjetrën ose duke i rotulluar ato.

Lavdëroni fëmijën për çfarë ka bërë në regull:

- Ti e bashkove figurën shumë mirë! Po, kështu është në regull!

59 Të tregosh me një libër



Çfarë mëson fëmija juaj?

- Fjalë të reja
- Të bëjë fjali me fjalë
- Të dëgjojë mirë
- Të mësohet me libra

Çfarë ju duhet?

- Një libër për fëmijë me figura

ÇFARË MUND TË BËNI?

- Shikojini bashkë me fëmijën tuaj figurat edhe flisni për to.
- Lexoni ose tregoni disa pjesë të shkurtëra nga libri dhe tregoni tek figurat për çfarë bëhet fjalë.
- Stimuloheni fëmijën për tu menduar duke i bërë pyetje për përallën, për shëmbull “Çfarë do bëjë ... tashi?”, “Ku do shkojë ... ?”, “Çfarë do ndodhi tashi?”.
- Shpjegoni kuptimin e fjalve të reja edhe, si pas mundësive, tregojini ato.
- Lezoheni ose tregoheni përallën me zëra të ndryshëm. Për shëmbull flisni për ariun me një zë të trashë: “Mmmh, sa mjalt i shijshëm,. Unë e dua atë!”
- Tregoheni përallën dhe i thoni fëmijës që edhe ai ta tregojë pastaj. Ju mund ta ndimoni atë me pyetje si “Çfarë bëri ... atje?”, “Çfarë ndodhi këtu?”

Lavdëroni fëmijën për çfarë ka bërë në regull:

- Sa bukur që ti e tregon përallën! Po, këtë bëri ... !

60 Të treqosh me një çorape



Çfarë mëson fëmija juaj?

- Të zhvillojë fantazinë e tij
- Të formulojë fjali të plota
- Të zgjidhi probleme
- Të mendohet bashkë me të tjerë

Çfarë ju duhet?

- Një çorape ose një leckë ku futet dora për tu larë

ÇFARË MUND TË BËNI?

- Visheni në dorën tuaj çorapen ose lecken (mund të përdorni edhe një kukull që është tamam për këtë punë).
- Krijoni me gishtin e madh dhe gishtat e tjerë një gojë. Bëjeni gojën të flasi ose të bëjë si patat, duke i hapur dhe mbylur gishtat me gishtin e madh.
- Bëni sikur kukulla do ta kafshojë fëmijën tuaj tek hunda ose tek krahu: “Unë do të të ha ty HAP!” (Nëqoftëse kjo i pëlqen fëmijës tuaj atëhere përsëriteni).
- Kukulla mund ti tregojë fëmijës për një problem që ka, për shëmbull “Unë humba kapelen time, ku ta kërkoj tashti? ... Ajo nuk është atje. Çfarë të bëj tashti?”.
- Do ishte fantastike që të arinit ta bënit fëmijën të flasi me kukullën sa të krijohet një dialog i vërtet për një problem që edhe fëmija juaj ka.
- Lodra bëhet akoma më shumë interesante nëqoftëse e lëvizni kukullën edhe flisni me zë tjetër.
- Lëreni edhe fëmijën që të lozi me çorapen ose leckën dhe të flasi me ju ndërmjet asaj.

Lavdëroni fëmijën për çfarë ka bërë në regull:

- E shikon, tashi e gjete kapelen tënde!
- Sa mirë që flet ti me kukullën!

61 Çfarë shkon me njëra-tjetrën?



Çfarë mëson fëmija juaj?

- Të shikojë tamam edhe të krasojë
- Të ushtrojë mëndjen e tij
- Fjalë të reja dhe grupime sendesh

Çfarë ju duhet?

- Disa gjëra shtëpiake të ndryshme që i ngjajnë njëra-tjetrës, përsëmbull lugë të ndryshme, kapse me ngjyrë, fije prej lëmshave të ndryshëm, komça,...

ÇFARË MUND TË BËNI?

- Pregatini materialet e nevojëshme.
- Stimuloheni fëmijën tuaj për të folur: “Për çfarë na duhen ne këto?”
- Tregoni fëmijës si ti përdori gjërat saktë dhe thoni emrin e tyre.
- I thoni fëmijës që ti sistemojë gjerat (ti vëri gjërat që shkojnë me njëra-tjetrën bashkë):
Kaset simbas ngjyrave: të kuqet me të kuqet, të verdhat me të verdhat, jeshilet me jeshilet
Pirunjtë dhe lugët e mëdha sëbashku dhe të voglat veç
Pirunjtë të ndara nga lugët
Lugët prej dërase të ndara nga ato prej metali
- I thoni grupimet e sendeve:
“Ne hamë me lugë e pirunj.”
“E kuqja dhe e verdha janë ngjyra.”
“Dërasa, plastika dhe metali janë materiale prej të cilave prodhohen gjëra.”

Lavdëroni fëmijën për çfarë ka bërë në regull:

- Po ajo është një kapse e kuqe, ajo e ka vëndin atje!
- Sa bukur që ti i sistemon gjërat!

62 Të lozësh me lego dhe duplo



Çfarë mëson fëmija juaj?

- Të ndërtojë
- me lego ose duplo
- Të shprehi
- fantazinë e tij
- Koordinim
- e syve dhe të duarve

Çfarë ju duhet?

- Lego ose duplo


ÇFARË MUND TË BËNI?

- Lëreni fëmijën të lirë të lozi me legot ose duplot
- Inkurajoheni fëmijën duke shprehur interes në veprimet e tij.
- I tregoni fëmijës si ti ndajë pjesët e bashkuara edhe të ndërtojë gjëra të reja. Vetëm në qoftëse ai nuk arin ti ndajë pjeset, ndihmoheni duke ja drejtuar pak duart.
- Lozni me atë çfarë fëmija ndërtovi
- Flisni me fëmijën tuaj, bëni pyetje: “Është kjo një shtëpi? Ëh, qënka një anije. Kush është kapiteni? Ka dhe marinarë?”

Lavdëroni fëmijën për çfarë ka bërë në regull:

- Ti i bashkon pjesët shumë mirë!
- Sa e lartë që është kulla jote!

63 Pjesët e trupit



Çfarë mëson fëmija juaj?

- Funksionet e trupit të tij
- Emrat e pjesëve të ndryshme të trupit

Çfarë ju duhet?

- Një pasqyrë
- Një pikturë ose fotografi e fëmijës tuaj
- Një libër që flet për trupin

ÇFARË MUND TË BËNI?

- I Shikoni me fëmijën tuaj pikturat/fotografitë dhe shpjegoni që do flisni për pjesët e trupit.
- Vini re çfarë është duke parë fëmija juaj, sepse ajo i intereson atij më shumë. I thoni fëmijës emrat e atyre pjesëve.
- Bëni pyetje për pjesët, për shëmbull "Si quhet kjo pjesë? Ku është ajo tek ty? Ke dhe tij një ... ? Çfarë bën ti me ... tënd/tënde?"
- Nëqoftëse ka nevojë ndimoheni fëmijën duke i thënë atij pjesën ose gërmën e parë të përgjigjes.

Lavdëroni fëmijën për çfarë ka bërë në regull:

- Po, tamam, kjo është një këmbë. Ku është këmba jote?

64 Familja ime



Çfarë mëson fëmija juaj?

- Mëson lidhjen/funksionin e pjestarve të familjes të tij.
- Fjalë të reja që kanë të bëjnë me familjen
- Mëson të njohi lidhjen familjare.

Çfarë ju duhet?

- Disa fotografi me pjesëtarët e familjes
- Letra për të vizatuar dhe lapsa me ngjyrë

ÇFARË MUND TË BËNI?

- I tregoni fëmijës fotografit dhe lëroni që të gjejë kush është personi në fotografi. Ai mund të tregojë dhe me gisht tek personi.
- Në vënd të fotografive ju mund edhe ti vizatoni pjesëtarët e familjes. Sigurisht që këto vizatime nuk duhet të jenë me domozdo identike. Ju pastaj mund ta përdorni vizatimin për të folur për familjen.
- Lëroni edhe fëmijën të vizatojë, në këtë rast akzeptoni si njerëz edhe disa rathë me viza.
- Tregoni me ndihmën e fotografive ose vizatimeve diçka për pjestarët e familjes: Kush janë ata, ku banojnë, çfarë eksperiencë kanë përjetuar me ju (ose fëmijën tuaj), ...
- I thoni e emrat e lidhjeve familjare: “Gjyshja është mamaja ime; Xhaja O. është vëllaji i babajit. ... “
- I thoni fëmijës t’ju tregojë të tërë fëmijët, pastaj të tëra grat, të tërë burat, ...

Lavdëroni fëmijën për çfarë ka bërë në regull:

- Po, ke të drejtë, gjyshi është babaji im.
- Sa bukur që e dallove tek fotografia!